

# STATUT

## “LE-DI CONSTRUCTION”

### SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në këtë statut

- “Ligi” është Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më **23.01.2024** (data e nënshkrimit të këtij Statuti), ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **“LE-DI CONSTRUCTION” SH.P.K.**

(2) Themeluesit e shoqërisë janë (mbiemrat, emrat ose forma dhe emri ligjor i shoqërisë; adresat ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit):

- Ermal Nake, i biri i Vaskë me datëlindje 25.07.1988, mbatjës i kartës së identitetit me nr. I80725038R, me adresë banimi: **Leskovik, Nd. 106, Leskovik, 7402, Kolonjë.**
- Anastats Kokëdhima, i biri i Theodhorit me datëlindje 23.03.1963, mbatjës i kartës së identitetit me nr. G30623128T, me adresë banimi: **Ruga Ismail Qemali, Nd. 18, H. 3, Ap. 49, Tirane**

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

Import- eksport të materialeve, mallrave e produkteve të ndryshme. Investimi, zbatimi, zhvillimi, projektimi, menaxhimi i zonave civile, industriale, turistike, si edhe shërbimeve të tjera të veprimtarive tregtare të ngjashme ose të lidhura me to. Kryerja e aktivitetit për investimin në fushën e ndërtimit për shitjen e banesave publike e private dhe për prodhim dhe shitblerje të materialeve të ndërtimit.

Punime të tokës dhe ndërtimë muresh; ndërtim të banesave civile, industriale, monumentale, kompletim të impianteve dhe përfundim të tyre; vepra restaurimi; ndërtim të asfaltit; të aeroporteve dhe hekurudhave; të galerive; të urave, të digave, vepra speciale të betonuara, punime hekurudhere, punime hidraulike; ujësjellësi; gazsjelli; vajgursjellsin, mbrojtjeje dhe sisteme hidraulike, agrare, pyjore, punime detare dhe të portit, impiante të mbarështrimit, të pastrimit të ujit të pijshëm, realizimit të impianteve të trajtimit të plehrave; realizimit të impianteve teknologjike dhe speciale për ndërtimin, realizimin e karpenterisë metalike; realizimin e impianteve për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë; zbulime; eksplorime të nëntruallit, rregullim të terreneve dhe shpim pusesh

Shoqëria do të kryejë punë për ndarjen në parcela dhe të urbanizimit në përgjithësi, projektim it, llogaritjeve statike, drejtim punësh si dhe të veprojë si koordinuese teknike



1

dhe administrative me sipërmarrje të tjera; të tregtojë dhe të prodhojë me shumicë detale të çfarëdo lloj materiali në përgjithësi për ndërtimin; sjelljen e pajisjeve dhe atrecaturave për kantiere, të kryejë blerjen, shitjen, ndërtimin, administrimin dhe shkëmbimin e pasurisë së palëvizhshme. Ajo mund të kryejë përvëç të gjitha veprimeve tregtare, financiare dhe kreditore, të tundshme dhe të patundshme, edhe qiramarrjen nëse është e nevojshme dhe e mundshme për vazhdimin dhe realizimin e qëllimit të shoqërisë. Dhënie ambientesh e objektesh me qira, si pasuri të luajtshme edhe të paluajtshme. Blerje-shitje pasuri të paluajtshme e të luajtshme, (prona të ndryshme, si troje, banesa, apartamente, etj.), pasuri këto në pronësi të shoqërisë "LE-DI CONSTRUCTION" ose në pronësi të shoqërive të tjera ose në pronësi të personave fizikë apo juridikë të tjerë të cilët autorizojnë shoqërinë "LE-DI CONSTRUCTION" për blerje-shitje. Veprimtari tregtare në fushën e ushqimit social, hoteleri, turizëm, shitje materiale ndërtimi. Rehabilitim dhe rikonstruksion objektesh të ndryshme me funksion civil shërbimesh dhe/ose banimi si dhe industrial, dhe monumente arkitekture të kategorive të ndryshme.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë : pa afat.

**Neni4:**

**Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Faik Konica, Zona kadastrale 8160, nr pasurie 6/408-N9, Volumi 40, faqe 80, Tirane.**

(2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: \_\_\_\_\_

(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

**ermalnake@outlook.com**

**Kreu II Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) Lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

**1. Ortaket themelues:**


2.

- Anastas Kokëdhima: Zotëruesi i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 51,000 (pesëdhjetë e njëmijë) Lekë që përbën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ermal Nake: Zotëruesi i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 49,000 (dyzet e nëntëmijë) Lekë që përbën 49% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

**Neni 6:**

**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit:**



The image shows two handwritten signatures in blue ink. One signature is on the left, and another is on the right, both appearing to be in the name of 'Notari'. There is also a small number '2' written near the right signature.

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin eshoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetërtë parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

  
Neku Xhaferi

- f) pjestimin e kuotave dhe anulimine tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj)riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproje si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbedhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### Neni 9

#### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo mëvonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 10 Kuorumi

Në rastin e marjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të

përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimitarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### Neni 13 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat):

- Anastats Kokëdhima,  
mbatjes i kartes se identitetit me  
nr. G30623128T,  
me adresë banimi:  
Rruga Ismail Qemali, Nd. 18,  
H. 3, Ap. 49, Tiranë.

### Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e securisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

5

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", **administratori detyrohet:**

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarise së shoqërisë në mëdësi;  
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;  
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;  
ç) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;  
d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.  
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.  
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.  
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:  
a) u kthen ortakëve kontributet;  
b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;  
c) u shpérndan aktivet shoqërisë;  
ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;  
d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

6

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim I asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV

##### Viti finanziar-ekspertet

###### Neni 16 Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimi, viti I pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

###### Neni 17 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perbatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Kreu V

Prishja -riorganizimi i shoqërisë

###### Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përfjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

###### Neni 19 Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

###### Neni 20 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21  
Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**O R T A K Ė T**

**E**

**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"LE-DI CONSTRUCTION" SH.P.K.**

**ANASTAT KOKËDHIMA**

**ERMAL NAKE**

*Ermal Nake  
Trottel*

*Anastat Kokëdhima*